



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



**EKONOMIA DHE BUXHETI**

*QERSHOR, 2009*

# Raporti Mujor

Qershor, 2009

Kontakt:

Telefon: ++355 (4) 225 8437

e-mail: [elami@minfin.gov.al](mailto:elami@minfin.gov.al)

[www.minfin.gov.al](http://www.minfin.gov.al)

## PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE .....	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE .....	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi mesatar i këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	7
7. Oferta e Parasë	8
8. Depozitat sipas Burimeve	9
SEKTORI FISKAL.....	10
1. Buxheti i Konsoliduar	10
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	11
ANEKSI STATISTIKOR.....	12


## VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Qershor, 2009 arriti në 102.5 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muaji Qershor ishte 2.3 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin Qershor 2009 ishte 93.59 lekë për dollarë dhe 130.76 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Qershor shënuan kuotat 7.22 përqind për depozitat 24 mujore, 6.80 për ato 12 mujore, 5.91 për 6 mujorët dhe 4.68 përqind për depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 12.03 përqind për huatë 12 mujore dhe 12.47 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 819.4 miliardë lekë në muajin Qershor, duke shënuar një rritje prej rreth 5.9 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave për 3 – mujorin e parë 2009* rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 130.9 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën Qershor 2009 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 32.96 miliardë lekë
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara në Qershor 2009* arritën në rreth 145.3 miliardë lekë ose rreth 93.2 përqind e planit për periudhën.
- *Shpenzimet gjithsej* arritën në rreth 178.3 miliardë lekë ose rreth 94.2 përqind e shpenzimeve të planifikuara për periudhën.

## ZHVILLIMET EKONOMIKE

### 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Qershor 2009 pësoi një rënie prej 0.6 përqind krahasuar me muajin Qershor dhe Prill, kur ky indeks shënonte përkatësisht -0.8 përqind dhe -0.1 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë



**Ndryshimet mujore të IÇK-së**

Burimi: INSTAT

ishin -0.8 përqind, -1.0 përqind dhe -0.4 përqind. Rritja me e madhe mujore, gjatë muajit Qershor u konstatua në grupin “Transporti” me 1.0 përqind, rritje e cila erdhi si rrjedhojë e rritjes së çmimit të naftës me 4.2 përqind dhe çmimit të benzinës me 7.6 përqind. Pësha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për

këtë grup të kenë pak efekte të ndieshme mbi normën e inflacionit.

Gjatë këtij muaji rënie më të madhe prej 1.7 % e pësoi indeksi i çmimit të grupit “Ushqim dhe pije joalkolike”.

**Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)**


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
<b>2008</b>	3.0	3.6	4.6	4.4	4.2	4.0
<b>2009</b>	2.1	1.9	1.6	1.9	2.1	2.3
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2008</b>	3.7	2.5	2.7	2.8	2.6	2.2
<b>2009</b>						

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin Qershor arriti në 2.3 përqind duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2008 dhe 2009 paraqiten në tabelën 1.

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Qershor 2009, arriti në 131.16 Lekë/Euro, duke shënuar një rënie prej 0.7 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Qershor një euro u këmbye me 130.76 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Qershor 2009, arriti në 93.59 lekë/dollarë duke shënuar një rënie prej 3.3 përqind kundrejt muajit Maj '09.




Në fund të muajit Qershor, dollari amerikan arriti nivelin 92.73 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Qershor të vitit të kaluar rezulton se monedha shqiptare është zhvlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 19.3 përqind dhe kundrejt monedhës europiane, Euro, me 7.5 përqind. Nënçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 1.401 euro/dollarë.


Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitetin e politikës fiskale, efikasitetin në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Qershor 2009, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 6.80 përqind, duke pësuar një rënie prej 0.12 përqind në krahasim me muajin maj '09 ku normat e interesit shënonin vlerën 6.92 përqind. Rënie për këtë muaj kanë pësuar depozitat me afat 6-mujor të krahasuara me muajin paraardhës me 0.19 përqind.



**Normat e interesit për depozitat**




**Normat e interesit për huatë**

përqind, 7.67 përqind dhe 6.37 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rritje në Yield-et e bonove të thesarit për afatet 12 dhe 3 - mujore të maturimit.

Normat e interesit për depozitat me afat 3 - mujor pësuan rënie me 0.17 përqind, ndërsa normat e depozitave me afat 1 - mujor pësuan një rritje prej 0.05 përqind krahasuar me muajin paraardhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rritje kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat 12, 6, 3 dhe 1 mujore. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Qershor pësoi një rënie me 0.75 pikë përqind, duke arritur në 12.03 përqind nga 12.78 përqind që ishte në muajin Maj '09. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësuan një rritje prej 0.66 pikë përqind krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Qershor arriti në 12.47 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Qershor 2009, për bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin përkatësisht 9.23

## 4. Bilanci i Pagesave

Graf - 5




### Bilanci i Pagesave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën Janar – Mars 2009 regjistroi një deficit të përgjithshëm prej 130.9 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.

Graf - 6




### Llogaria Korente

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i deficitit të llogarisë korente prej 334.2 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën Janar'09 - Qershor'09 rezultoi: (i) bilanci tregtar -516.44 mln euro, (ii) shërbime neto -26.84 mln euro, (iii) të ardhura neto -4.36 mln euro, (iv) transferta neto 213.44 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në grafikun 6.

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Qershor 2009, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 9,398.2 milionë lekë krahasuar me fundvitin 2008. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 14,071.6 milionë lekë dhe të rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 4,673.4 milionë lekë.



Në muajin Qershor sistemi bankar rezultoi me një rritje prej 13,317.7 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin maj '09, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 1,740.7 milionë lekë si dhe të rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 11,576.9 milionë lekë.


## 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Qershor 2009 arriti në 418 miliardë lekë. Rënia e tepricës së kredisë, krahasuar me muajin maj '09 shënoi vlerën 5.3 miliardë lekë, me një rënie prej rreth 1.3 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar gjatë këtij muaji shënoi rënie e parë që prej vitit 2008.

Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 69.2 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 289.1 miliardë lekë.

Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 34.9 përqind.


## 7. Oferta e Parasë



**Agregati M3 Qer '08- Qer '09**

Burimi: Banka e Shqipërisë


Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Qershor ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës maj '09. Kjo ofertë arriti në rreth 819 miliardë lekë në fund të muajit Qershor duke shënuar një rritje prej 0.4 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin maj 2009. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 5.9 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar.



**Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rënie prej 2.4 miliardë lekë në krahasim me muajin maj.



**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë gjatë muajit Qershor, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 79.6 përqind të depozitave totale në valutë.


## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Qershor 2008 “sektorë të tjerë rezident”, zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 46.9 përqind, ndjekur nga “korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 38.4 përqind dhe nga “korporata publike jofinanciare”, me 12.6 përqind. “Sektorë të tjerë rezident” dhe “korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 79.6 përqind dhe rreth 16.0 përqind. “Sektorë të tjerë rezident” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i Depozitave të tjera në lekë (94.7 përqind e totalit)

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezident” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 512

miliarde) të depozitave totale, prej rreth 610 miliardë lekë në muajin Qershor 2008. Ata ndiqen nga “korporata të tjera jofinanciare” (75 miliardë), “korporatat jo-financiare publike” (18.9 miliardë) dhe “korporata të tjera financiare” (4.3 miliardë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1.0 miliardë në totalin e depozitave. Gjatë muajit Qershor 2008, krahasuar me një muaj më

Graf - 12



### Përberja e depozitave


Burimi: Banka e Shqipërisë

parë maj, niveli i përgjithshëm i depozitave u ul me 2.4 miliardë lekë, si rezultat i rritjes së depozitave në lekë dhe rënies së atyre në valutë .

## SEKTORI FISKAL

### 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhen Janar - Qershor 2009 janë mbledhur rreth 145.3 miliardë lekë të ardhura, përkundrajt shpenzimeve të përgjithshme prej 178.3 miliardë lekë, që përfshijne 129.6 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 48.6 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 84.0 % financim i brendshëm, dhe 15.9 % financim i huaj.



Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 43.4 % të të ardhurave buxhetore për vitin 2009, ndërsa shpenzimet përbëjnë 45.7 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë rreth 45.7 % e planifikimit vjetor, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 50.9 % e këtij planifikimi.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave është rreth 100.7 miliardë lekë (ose rreth 43.8 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 6.9 miliarde lekë

(37.4 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 25.5 miliarde lekë (44.4 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin e 10.9 miliardë lekë (48.7 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i shpenzimeve korrente prej 129.6 miliardë lekë, 29.6 miliardë lekë (22.8 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, 17.4 miliardë lekë (13.4 %) për interesat, 13.9 miliardë lekë (10.7 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.2 miliardë lekë (0.9 %) për subvencione, 44.9 miliardë lekë (34.7%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 15.1 miliardë lekë (11.6 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 7.4 miliardë lekë (5.7 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 49.6 % (shpenzime personeli), 48.3 % (shpenzime për interesat), 38.9 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 58.6 % (subvencione), 46.9 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 40.9 % dhe 44.1 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrajt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 55.5 % të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është vetëm 35.6 %.

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Qershor 2009 ishin rreth 145.3 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore në rreth 133.1 miliardë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 10.9 miliardë

**Tab - 2** Të ardhurat e realizuara në Janar - Qershor 2009

Burimi	Miliardë Lekë
TVSH	52.12
Tatimi mbi fitimin	9.13
Taksa doganore	3.56
Taksat nacionale	7.80
Akcizat	14.39

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Defiçiti prej 32.9 miliardë lekë, për periudhën Janar - Qershor 2009, u mbeshtet në vlerën 16.99 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe 15.95 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjete kryesor i financimit të brendshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin Qershor disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 24.68 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 37.35 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për këtë periudhë kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 17.99 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 25.69 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me 11.66 miliardë lekë.

## Aneksi Statistikor

Tab - 1

## Ndryshimi i Indeksit të Çmimemeve të Konsumit

Change of Consumer Prices Index

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2005	2006	2007	2008	2009	2005	2006	2007	2008	2009	2005	2006	2007	2008	2009	
Janar	0.8	0.2	0.5	0.5	0.4	0.80	0.20	0.50	0.50	0.40	3.3	1.4	2.9	3.0	2.1	January
Shkurt	0.4	0.4	0.5	1.0	0.7	0.60	0.30	0.50	0.75	0.55	1.8	1.3	2.9	3.6	1.9	February
Mars	0.0	0.1	-0.1	0.9	0.6	0.40	0.23	0.30	0.80	0.57	1.6	1.5	2.7	4.6	1.6	March
Prill	-0.3	0.6	-0.2	-0.4	-0.1	0.23	0.33	0.18	0.50	0.40	1.3	2.4	1.9	4.4	1.9	April
Maj	-1.1	-0.4	-0.8	-1.0	-0.8	-0.04	0.18	-0.02	0.20	0.16	2.0	3.1	1.4	4.2	2.1	May
Qershor	-0.5	-1.1	-0.6	-0.8	-0.6	-0.12	-0.03	-0.12	0.03	0.03	2.9	2.4	2.0	4.0	2.3	June
Korik	-1.2	-0.4	-0.3	-0.6		-0.27	-0.09	-0.14	-0.06		1.8	3.2	2.1	3.7		July
Gusht	0.2	-0.2	1.9	0.6		-0.21	-0.10	0.11	0.03		2.3	2.8	4.2	2.5		August
Shtator	0.9	0.6	0.9	1.1		-0.09	-0.02	0.20	0.14		3.1	2.6	4.4	2.7		September
Tetor	0.4	0.1	-0.1	0.1		-0.04	-0.01	0.17	0.14		3.3	2.2	4.2	2.8		October
Nendor	0.2	0.9	0.2	-0.1		-0.02	0.07	0.17	0.12		3.0	2.9	3.5	2.6		November
Dhjetor	2.2	1.8	1.3	0.9		0.10	0.22	0.27	0.18		2.0	2.5	3.1	2.2		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

**Tab - 2** Kursi i kembimit  
Exchange rate

Leke per njesi te monedhes se huaj (Leke per unit of foreign currency)

Monedha	2004	2005	2006	2007	2008	2009						Currency
						Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	
<i>Mesatarja e periudhes</i>												<i>Average of period</i>
USD	102.78	99.86	98.10	90.43	90.96	94.62	100.65	100.50	98.83	96.80	93.59	USD
EURO	127.67	124.19	123.08	123.63	123.18	125.18	128.79	130.67	130.46	132.05	131.16	EURO
<i>Fundi i periudhes</i>												<i>In the end of period</i>
USD	92.64	103.58	93.67	82.89	87.91	98.10	102.49	98.63	98.48	94.45	92.73	USD
EURO	126.35	122.58	123.70	121.78	123.80	126.30	129.84	131.02	131.08	132.50	130.76	EURO

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me baze vjetore

Annual Interest Rates

2009									
Ne perqindje Fundi I periudhes	Dhjetor 07 Dec	Dhjetor 08 Dec	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	In percent End of period
<b>Norma e remunerimit</b>									<b>Remuneration rate</b>
ne leke	-	4.37	4.37	4.03	4.02	4.02	4.02	4.02	In Lek
ne usd	-	0.70	0.09	0.09	0.09	0.09	0.09	0.09	In USD
ne euro	-	2.28	1.75	1.40	1.40	1.05	0.88	0.70	in EURO
<b>Norma e depozitave</b>									<b>Deposits rates</b>
12-M	6.33	6.86	6.93	6.68	6.57	6.67	6.92	6.80	12-M
6-M	5.50	5.76	6.05	5.69	5.52	5.86	6.10	5.91	6-M
3-M	4.85	5.23	6.32	5.13	4.97	4.96	4.85	4.68	3-M
1-M	3.21	3.95	3.95	3.94	4.29	3.85	4.87	4.92	1-M
<b>Norma e huase</b>									<b>Lending rates</b>
12-M	13.55	10.76	12.85	13.12	12.96	12.79	12.78	12.03	12-M
6-M	13.85	11.18	11.74	11.31	11.12	12.75	11.81	12.47	6-M
<b>Norma e letrave me vlere</b>									<b>Securities rates</b>
Bobo thesari 1/									Treasury bills 1/
3-M	6.48	6.19	6.30	5.99	6.08	6.30	6.28	6.37	3-M
6-M	7.51	7.45	7.46	7.46	7.61	7.68	7.67	7.67	6-M
12-M	8.41	8.56	8.84	8.87	9.07	9.13	9.15	9.23	12-M

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

**Tab - 4** TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2009  
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2009

*ne milion leke (in million leks)*

Te dhena progresive (Progressive Data)							ne milion leke (in million leks)		
Nr.	E M E R T I M I	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	ITEM	No.
	<b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>	<b>23,170</b>	<b>44,458</b>	<b>72,289</b>	<b>97,600</b>	<b>120,600</b>	<b>145,287</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>	
I.	Ndihma	0	55	231	576	623	1,196	Grants	I.
II.	Te ardhura tatimore	21,378	41,405	64,320	88,715	110,732	133,119	Tax Revenue	II.
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	15,372	30,720	48,261	65,486	82,728	100,719	From tax offices and customs	II.1
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	8,244	16,543	24,443	33,352	42,422	52,126	V. A. T	1
2	Tatimi mbi Fitimin	1,089	2,394	5,498	6,720	8,171	9,127	Profit Tax	2
3	Akcozat	2,163	4,341	6,896	9,194	12,236	14,396	Excise Tax	3
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	2,168	4,016	6,069	8,586	10,455	13,700	Personal Income Tax	4
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	1,246	2,434	3,694	5,352	6,473	7,803	National Taxes and others	5
6	Taksa Doganore	461	991	1,662	2,282	2,970	3,567	Custom Duties	6
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	1,025	1,718	3,011	5,217	6,102	6,885	Revenues from Local Gov.	II.2
1	Tatimi mbi pasurine	86	170	453	454	455	456	Tax on land	1
2	Tatimi mbi Biznesin e vogel	424	524	826	1,449	1,422	1,476	Small Business Tax	2
3	Taksa lokale	515	1,023	1,732	3,315	4,226	4,954	Local Taxes	3
II.3	Te ardh. Buxh. Pavarur	4,982	8,967	13,048	18,012	21,902	25,514	Social Ins	II.3
1	Sigurimi Shoqeror	4,476	7,997	11,872	16,101	19,476	22,684	Social Insurance	1
2	Sigurimi Shendetosor	505	969	1,176	1,911	2,425	2,830	Health insurance	2
III.	Te ardhura Jotatimore	1,792	2,998	7,739	8,309	9,246	10,972	Non-tax Revenue	III.
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0	0	1,241	1,241	2,241	2,241	Profit transfer from BOA	1
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	8	15	26	34	43	60	Income of budgetary institutions	2
3	Dividenti, Gjoha dhe Sekuestrime	176	329	610	761	861	995	Divident fines	3
4	Tarifa sherbimesh	1,518	2,549	5,731	6,002	5,808	7,365	Services	4
5	Te tjera dhe interese	90	105	130	272	293	312	Other/not allocated	5
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>21,711</b>	<b>47,910</b>	<b>76,042</b>	<b>107,447</b>	<b>140,886</b>	<b>178,243</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>	I.
I.	Shpenzime Korrente	17,337	37,300	57,842	80,177	103,616	129,606	Current Expenditures	I.1
I.1	Personeli	4,971	9,086	14,075	19,298	24,299	29,611	Personnel expenditures	1
1	Paga	4,053	7,472	11,619	16,005	20,188	24,720	Wages	2
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	918	1,614	2,456	3,293	4,111	4,891	Social insurance contributions	3
3	Politikat e reja pagash							Of which: Contingency	
I.2	Interesat	3,454	6,668	8,434	10,803	13,816	17,423	Interest	I.2
1	Te Brendshme	3,272	5,958	7,639	9,729	12,264	15,389	Domestic	1
2	Te Huaja	182	710	795	1,074	1,552	2,034	Foreign	2
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	992	2,803	5,348	7,982	10,793	13,931	Operational & Maintenance	I.3
I.4	Subvencionet	117	396	474	608	1,069	1,184	Subsidies	I.4
I.5	Mbeshtetje per Energjine								I.5
I.5	Shpenzime per Sig.Sociale dhe te tjera	5,941	13,489	20,997	28,711	36,616	44,939	Social insurance outlays	I.5
1	Sigurime Shoqerore	5,220	10,504	16,024	21,854	27,971	34,667	Social insurance	1
2	Sigurime Shendetosore	721	2,986	4,973	6,857	8,644	10,272	Health insurance	2
I.6	Shpenzime per Buxhetin Lokal	1,091	2,913	5,264	8,159	11,402	15,083	Local Budget	I.6
I.7	Shpenzime te tjera	772	1,944	3,250	4,616	5,922	7,436	Other expenditures	I.7
1	Pagesa e Papunesise	64	120	195	262	363	397	Unemployment insurance benefits	1
2	Ndihma Ekonomike	709	1,824	3,054	4,354	5,559	7,039	Social assistance	2
3	Kompensim per ish te perndjekurit politike							Compensation for ex political prisoners	3
I.8	Kompensim ne vlere i pronareve							Property Compensation	I.8
II.	Fondi Rezerve							Reserve fund/contingency	II.
III.	Shpenzime Kapitale	4,373	10,610	18,201	27,186	36,885	48,552	Capital expenditures	III.
1	Financimi Brendshem	4,091	9,972	16,390	23,886	32,853	40,796	Domestically financing	1
2	Financimi Huaj	282	638	1,811	3,300	4,032	7,757	Foreign financed	2
IV	Transferita Kapitale	0	0	0	84	84	85	Capital Transfer	
	<b>DEFICITI</b>	<b>-1,459</b>	<b>-3,453</b>	<b>-3,753</b>	<b>-9,846</b>	<b>-20,285</b>	<b>-32,956</b>	<b>Deficit</b>	
	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-1,459</b>	<b>3,453</b>	<b>3,753</b>	<b>9,846</b>	<b>20,285</b>	<b>32,956</b>	<b>Deficit Financing</b>	
	Brendshem	-1,440	3,477	2,930	8,085	6,064	16,998	Domestic	
	Te ardhura nga privatizimi	9,802	9,815	9,825	15,380	15,440	20,779	Privatization receipts	
	Hua-marje e brendeshme	-5,053	-6,575	-3,086	440	2,914	4,970	Domestic Borrowing	
	Kredi Direkte	0	-3,000	4,000	4,000	-3,000	-3,000	Direct Credit	
	REPO e anasjellite						8	REPO	
	Te tjera	-6,189	237	-3,810	-7,734	-12,290	-8,758	Other	
	I Huaj	-19	-24	823	1,761	14,222	15,958	Foreign	
	Hua afatgate(e marre) nga e cila:	223	810	2,058	2,781	15,371	19,454	Long-term Loan(Drawings)	
	Ndryshimi i gjendjes se arkës*	83	-212	-461	-47	262	-711	Chang. of stat. Account*	
	Ripagesat	-324	-622	-773	-973	-1,411	-2,786	Repayments	
	<b>KAPITUJT KRYESORE</b>							<b>Main indicators</b>	
	Financimi i Brendshem i Deficitit	-1,440	3,477	2,930	8,085	6,064	16,998	Domestically financed deficit	
	Deficiti Pergjithshem	-1,459	-3,453	-3,753	-9,846	-20,285	-32,956	Overall Balance	
	Te ardh. Shpen. nga Sig. Shoq. dhe Shend.	-959	-4,523	-7,949	-10,699	-14,714	-19,425	Soc. & health insur.contr.-outlays	

\* "Ndryshimi i gjendjes se arkës" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja

"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit preliminary data

Te dhena operative

**Tab - B** SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT INSTITUCIONAL PER VITIN 2009  
Expenditures by central institutions during the year 2009

Te dhena progresive (Progressive Data)

ne milion leke (in million leks.)

Ministria ose Institucioni	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Ministria or Institution
<b>Totali</b>	<b>21,711</b>	<b>47,910</b>	<b>76,042</b>	<b>107,447</b>	<b>140,686</b>	<b>178,243</b>	<b>Total</b>
Presidenca	13	31	58	71	86	97	President
Kuvendi	78	144	214	283	364	428	Parliament
Keshilli i Ministrave	24	48	67	95	120	142	Council of Ministers
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	47	130	228	363	978	1,150	Ministry of Economy, Trade & Energy
Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit dhe mbrojtjes se Konsumatorit	232	427	655	967	1,260	1,755	Ministry of Agriculture, Food & Consumers Safety
Ministria e Puneve Publik, Transportit dhe Telekomunikacionit	4,235	9,645	16,839	25,049	33,954	44,079	Ministry of Public Work, Transport & Telecommunication
Ministria e Financave	314	734	1,249	1,773	2,237	2,781	Ministry of Finance
Ministria e Arsimit dhe Shkences	2,438	4,962	7,833	11,074	13,881	17,006	Ministry of Education & Science
Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	73	189	332	434	657	854	Ministry of Tourism, Culture, Youth & Sport
Ministria e Shendetesise *	1,413	3,608	6,101	8,492	10,682	13,097	Ministry of Health
Ministria e Drejtësisë	230	564	1,409	1,797	2,161	2,583	Ministry of Justice
Ministria e Puneve te Jashtme	172	393	520	700	878	1,045	Ministry of Foreign Affairs
Ministria e Brendshme	766	1,756	2,836	3,933	5,269	6,513	Ministry of Interior
Ministria e Mbrojtjes	719	2,232	3,181	4,512	5,576	7,372	Ministry of Defense
Sherbimi Informativ i Shtetit	77	158	249	338	424	521	State Information Service
Drejtoria e Radio-Televizionit	45	85	129	264	323	392	Department of Radio and Television
Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	14	29	48	56	68	93	General Directorate of Archive
Sherbimi i Kontrollit te Shtetit	20	42	62	85	106	127	State Audit Commission
Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te barabarta**	5,857	12,236	18,927	26,062	33,371	41,161	Ministry of Labor and Social Affairs & Equal Possibilities
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	61	150	320	449	636	784	Ministry of Environment, Forestry & Water Administration
Prokuroria e Pergjithshme	71	150	235	327	424	528	State Prosecutor
Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	82	181	315	437	559	668	Office for the Administration of the Judiciary Budget
Gjykata Kushtetuese	5	13	20	31	39	46	Constitutional Court
Agjensia Telegrafike Shqiptare	8	16	25	33	41	48	Albanian Press Agency
Shpenzime per sherbimin e borxhit	3,454	6,668	8,434	10,803	13,816	17,423	Dept Service
Instituti i Statistikes	11	21	41	57	73	94	Statistics Institute
Shkolla e Magjistratures	4	6	9	13	16	19	School of the Magistrature
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	79	109	129	242	368	721	Rural Development Program
Qendra Kombetare Kinematografike	8	10	19	21	40	63	National Movies Center
Instituti i integrimit te perndjekurve	2	6	12	19	20	24	Institute of integration of the ex-political prisoners
Inspektorjati i keshillit te larte te drejtësisë	4	9	13	18	22	28	Inspection of the high Council of Justice
Avokati i popullit	9	17	25	34	41	48	Ombudsman
Komisioni i Sherbimit Civil	3	5	7	11	14	14	Commission of civil service
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	7	15	20	29	118	264	Central Committee for Elections
Entet Lokale "Granti"	1,091	2,913	5,264	8,159	11,402	15,083	Local Entities "Grant"
Inspektorjati i Larte Kontr. Deklar te Pronave	3	9	14	21	29	38	High Inspectoriate for Declaration of Properties & Assets
Autoriteti i Konkurences	3	7	12	21	25	31	Competition Authority
Ministria e Integrimit	7	19	27	39	49	58	Ministry of Integration
Agjentet tatimor	11	15	24	50	95	122	Tax agents not-budgetary
Keshilli Kombetar i Kontabilitetit	1	1	2	3	3	4	Accounting council
Avokati i Prokurimeve	4	6	8	14	15	16	Procurement
Te tjera	16	150	131	268	645	925	Others

Te dhena operative

preliminary data

Tab - 6

SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL PER VITIN 2009  
EXPENDITURES BY FUNCTIONS YEAR 2009

*Te dhena progresive (Progressive Data)* *ne milion leke (in million leks)*

Kodi	Funksionet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Functions	Code
		Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun		
	<b>TOTAL</b>	<b>21,711</b>	<b>47,910</b>	<b>76,042</b>	<b>107,447</b>	<b>140,886</b>	<b>178,243</b>	<b>TOTAL</b>	
01	Sherbimet e Pergjithshme Publike *	5,102	10,520	15,212	20,344	26,061	32,772	General Public Services*	01
02	Mbrojtja	467	1,596	2,211	3,184	3,925	4,680	Defense	02
03	Rendi dhe Siguria Publike	906	2,112	3,423	4,758	6,212	7,564	Public Order and Safety	03
04	Ceshtjet Ekonomike	4,561	10,333	17,860	26,785	37,620	48,527	Economic affairs	04
05	Mbrojtja e Mjedisit	5	12	33	47	65	79	Environmental protection	05
06	Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	413	1,299	2,421	3,649	4,956	7,556	Housing and community amenities	06
07	Shendetesia	1,428	3,636	6,151	8,562	10,776	13,202	Health	07
08	Argetimi, Kultura dhe Ceshtjet Fetare	198	441	720	1,083	1,477	1,929	Recreation, culture and religion	08
09	Arsimi	2,482	5,120	8,161	11,609	14,617	18,017	Education	09
10	Mbrojtja Sociale	6,149	12,842	19,850	27,341	35,090	43,833	Social protection	10
	<i>Other (Capital Transfer)</i>	0	0	0	84	84	85		

*\*Pershin dhe shpenzimet per interesa* *\* Includes interest payments*  
*Te dhena operative* *preliminary data*

Tab - 7

## Tabela e investimeve 2009

Table of investments 2009

*Te dhena progresive (Progressive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	
	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	
<b>Financim i brendshem</b>	<b>4,091</b>	<b>9,972</b>	<b>16,390</b>	<b>23,886</b>	<b>32,853</b>	<b>40,796</b>	<b>Domestic financing</b>
<i>Ne %</i>	93.54%	93.99%	90.05%	87.86%	89.07%	84.02%	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	<b>282</b>	<b>638</b>	<b>1,811</b>	<b>3,300</b>	<b>4,032</b>	<b>7,757</b>	<b>Foreign financing</b>
<i>Ne %</i>	6.46%	6.01%	9.95%	12.14%	10.93%	15.98%	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>4,373</b>	<b>10,610</b>	<b>18,201</b>	<b>27,186</b>	<b>36,885</b>	<b>48,552</b>	<b>Total</b>
<i>Ne %</i>	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	<i>In %</i>

Tab - 8

**TE ARDHURAT NGA ZYRAT E DOGANAVE 2009**  
**REVENUES FROM CUSTOMS OFFICE 2009**

Te dhena progresive (Progressive Data)

ne milion leke/ in million leks)

